VENDIM
Nr. 827, datë 30.12.2025

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.3 55, DATË 20.4.2018, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR TRANSFERIMIN E PRONËS SHTETËRORE NË ZONËN KADASTRALE NR. 2085, KARAVASTA E RE, NJËSIA ADMINISTRATIVE REMAS, BASHKIA DIVJAKË, NË FONDIN E PASURIVE TË PALUAJTSHME PËR MBËSHTETJEN E INVESTIMEVE STRATEGJIKE DHE VËNIEN NË DISPOZICION PËR ZHVILLIMIN DHE REALIZIMIN E PROJEKTIT INVESTUES STRATEGJIK "NGRITJA E PLANTACIONIT ME SHEGË, GOJI BERRY, KIVI, RRUSH, DARDHË ETJ., SI DHE ZHVILLIMIN E AGROTURIZMIT NË NJË SIPËRFAQE RRETH 131 HA, NË ZONËN E KARAVASTASË, BASHKIA DIVJAKË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 27, të ligjit nr. 55/2015, "Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 355, datë 20.4.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për transferimin e pronës shtetërore në zonën kadastrale nr. 2085, Karavasta e Re, njësia administrative Remas, Bashkia Divjakë, në fondin e pasurive të paluajtshme për mbështetjen e investimeve strategjike dhe vënien në dispozicion për zhvillimin dhe realizimin e projektit investues strategjik "Ngritja e plantacionit me shegë, goji berry, kivi, rrush, dardhë etj., si dhe zhvillimin e agroturizmit në një sipërfaqe rreth 131 ha, në zonën e Karavastasë, Bashkia Divjakë", të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në titull dhe në pikat 2, 4 dhe 5, pas fjalëve "... në një sipërfaqe rreth 131 ha ... " shtohen "... dhe të aktivitetit agrivoltaik në një sipërfaqe prej 68.6 ha ...".

b) Në pikën 3, pas fjalëve "... nr. 6/9, datë 24.6.2020 ..." shtohen "... dhe vendimin nr. 6 /16, datë 30.10.2023 ...".

c) Kudo në vendim, emërtimi "Ministria e Financave dhe Ekonomisë" zëvendësohet me "Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit".

2. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, Bashkia Divjakë, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Lushnjë dhe investitori strategjik "Agro Iliria Group" sh.p.k., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama